

UNIVERSITETI I PRISHTINËS	
Fakulteti i Arteve	
PLAN- PROGRAMI MËSIMOR- SYLLABUS	
VITI AKADEMIK 2024/ 2025	
Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve/ Programi Artet Vizuale/ Profili Pikturë
Titulli i lëndës:	Pikturë I
Niveli:	Bachelor- BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë/ semestri I-II
Numri i orëve në javë:	6 (gjashtë) + 2 (dy)
Vlera në kredi – ECTS:	18 (tetëmbëdhjetë)
Koha / lokacioni:	E hënë: 09:00-11:15 h / Klasa e Pikturës E martë: 09:00-11:15 h / Klasa e Pikturës
Mësimdhënësi i lëndës:	PROF. MR. VISAR MULLIQI
Detajet kontaktuese:	E-mail: visar.mulliqi@uni-pr.edu Mob.tel. +383 (0) 49 588 567
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Lënda Pikturë I në vitin e parë të studimeve Bachelor, përqendrohet në studimin e teknikave dhe koncepteve të pikturës klasike dhe bashkëkohore, duke përfshirë zhvillimin e aftësive teknike dhe kompozicionale si dhe perceptimin vizual dhe hapësinor. Elementet kryesore të studimit janë ngjyrat dhe tonet e tyre, dritë-hija, forma, perspektiva, planet dhe kompozicioni, duke përfshirë edhe materializimin e formave dhe analizën kritike të tyre.</p> <p>Studentët mësojnë përdorimin e medimeve dhe teknikave të ndryshme të pikturimit, me theks të veçantë në ngjyrat e vajit dhe akrilikut. Lënda synon të aftësojë studentët për të aplikuar një shumëllojshmëri teknikash, për të krijuar harmoni dhe kontrast në pikturë, si dhe për të organizuar hapësirën artistike në mënyrë të efektshme.</p> <p>Programi gjithashtu inkurajon zhvillimin e syrit analitik dhe kritik, duke i pajisur studentët me aftësi</p>

	<p>për të studiuar dhe interpretuar formën, lëvizjen dhe dinamikën e modelit të gjallë. Përmes një procesi krijues të strukturuar, studentët punojnë me tema dhe projekte të veçanta, ndërsa blloku i skicave shërben si bazë e rëndësishme për studimin dhe zhvillimin e ideve të tyre artistike.</p> <p>Qëllimi i lëndës është krijimi i një mjedisi frymëzues që promovon mendimin kritik dhe stimulon kënaqësinë në procesin e krijimtarisë. Programi ndihmon studentët të avancojnë në vizionin e tyre artistik, të zhvillojnë ndjeshmërinë ndaj ngjyrave dhe të eksplorojnë medime të ndryshme në mënyrë që të përgatiten për angazhime më të avancuara në artin pamor dhe krijues.</p> <p>Lënda ofron një bazë të fortë për përfshirjen e studentëve në komunitetin artistik dhe hap mundësi të shumta për të manifestuar potencialin e tyre krijues.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Kjo lëndë ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të zhvillojnë aftësi të avancuara të observimit vizual <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të analizojnë dhe interpretojnë forma, dritë-hije, vëllim, perspektivë vizuale dhe hapësinore. ● Të ndërtojnë kompozicione të fuqishme dhe kreative <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të aftësohen në krijimin e kompozicioneve harmonike duke përdorur elementet dhe parimet e artit pamor. ● Të përvetësojnë përdorimin e materialeve dhe medimeve të ndryshme në pikturë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojnë dhe aplikojnë teknikat e ndryshme me ngjyra vaji, akriliku dhe medime të tjera të përshtatshme për projekte specifike. ● Të konsiderojnë bllokun e skicave si mjet kryesor për zhvillimin e ideve artistike

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krijojnë një rutinë të vazhdueshme të dokumentimit dhe eksperimentimit përmes skicave. ● Të punojnë në tema dhe projekte të strukturuar <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të trajtojnë cikle punësh në kuadër të projekteve me afate kohore të përcaktuara, duke zhvilluar shprehi për planifikimin dhe realizimin e vazhdueshëm të punës artistike. ● Të shfrytëzojnë dhe të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë teknike <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të demonstrojnë përdorimin efektiv të teknikave të mësuara në krijimin e punëve të personalizuar artistike. ● Të njohin dhe të përjetojnë fuqinë estetike dhe emocionale të ngjyrave <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojnë përzierjen dhe efektet hapësinore të ngjyrave për të krijuar harmoni dhe kontrast në pikturë. ● Të aftësohen në realizimin e portretit dhe autoportretit <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të studiojnë dhe pikturojnë portrete bazuar në modele antike dhe modele të gjalla, duke përfshirë trajtimin e enterierit dhe materialeve përcjellëse. ● Të zhvillojnë qasje të strukturuar dhe të orientuar drejt projekteve artistike <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krijojnë dhe realizojnë seri pikturash në formë të projekteve të vazhdueshme, duke ndjekur qasje bashkëkohore dhe standarde të larta profesionale. <p>Këto qëllime synojnë të zhvillojnë tek studentët jo vetëm aftësitë teknike dhe artistike, por edhe një mënyrë mendimi kritik, estetik dhe të disiplinuar për të kontribuar në fushën e artit bashkëkohor.</p>
--	--

<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Studenti do të:</p> <p>Njohuri</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të kuptojnë dhe interpretojnë konceptet bazë të pikturës, përfshirë observimin, dritë-hijen, ngjyrat, tonet, perspektivën, kompozicionin, materializimin e formave dhe teksturave. ● Të njihen me vetitë dhe fuqinë shprehëse të ngjyrave, përfshirë përzierjen e tyre, gradacionin dhe efektet estetike e emocionale të ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta. ● Të kenë njohuri për përdorimin e materialeve dhe teknikave kryesore, duke përfshirë ngjyrat e vajit, akrilikun dhe mediumet e tjera, si dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve artistike. ● Të zhvillojnë njohuri teorike mbi zhvillimet historike dhe bashkëkohore të pikturës, si dhe mbi portretin, autoportretin dhe enterierin. ● Të kuptojnë rëndësinë e bllokut të skicave dhe ditarit të ideve si mjete dokumentimi dhe zhvillimi artistik. <p>Aftësi</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të vizatojnë, konstruktojnë dhe pikturojnë natyrën e qetë dhe peizazhin duke filluar nga forma gjeometrike deri te format më komplekse, bazuar në observim. ● Të zhvillojnë dhe kontrollojnë hapësirën në pikturë, duke aplikuar harmoninë, dinamikën, kontrastin dhe lëvizjen për të krijuar kompozicione të balancuara dhe kreative. ● Të përdorin në mënyrë të pavarur materiale dhe teknika të ndryshme, duke zbatuar njohuritë për vetitë e ngjyrës së vajit dhe mediumeve të tjera. ● Të konceptojnë dhe realizojnë projekte artistike, duke dokumentuar procesin krijues përmes
--	---

	<p>skicave dhe shënimeve në ditar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të hartojnë dhe prezantojnë ese reflektuese dhe seminare që analizojnë proceset dhe rezultatet e tyre krijuese, duke ndërtuar mendim kritik për artin bashkëkohor. • Të pikturojnë lirshëm dhe të avancojnë idetë e tyre personale gjatë procesit krijues. <p>Kompetenca</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorin njohuritë teorike dhe teknike për të zhvilluar dhe përfunduar punime artistike me cilësi të lartë, duke trajtuar tema të caktuara dhe duke realizuar cikle punësh. • Të demonstrojnë përgjegjësi dhe aftësi organizative në planifikimin dhe realizimin e projekteve brenda afateve kohore të caktuara. • Të zhvillojnë vizionin e tyre artistik dhe të përvetësojnë një qasje të personalizuar krijuese, duke reflektuar mbi punën e tyre dhe duke aplikuar kritikën për përmirësim të vazhdueshëm. • Të punojnë në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me kolegët dhe mësuesin, duke marrë pjesë aktive në diskutime grupore dhe individuale. • Të integrojnë analizën teorike me praktikën artistike për të krijuar piktura që pasqyrojnë balancën midis estetikës dhe teknikës. • Të hulumtojnë dhe aplikojnë qasje inovative në trajtimin e kompozicionit, ngjyrës dhe materialit për të zgjeruar potencialin e tyre krijues. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	6	30	180

Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	60
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	30	30
Ushtrime në teren	6	2	12
Kollokfiume, seminare	1	8	8
Detyra të shtëpisë	3	30	90
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	20	40
Përgatitja përfundimtare për provim	6	4	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	6	6
Projektet,prezantimet ,etj			
Totali			450
Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> ● Programi do të përqëndrohet në realizimin e punëve praktike të përcjella nga shkrime të shkruara nga studentët. ● Mësimdhënia do të zhvillohet duke u bazuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet mësimdhënësit dhe studentëve. ● Do të mbahen ligjërata të rëndësishme nga mësimdhënësi në 40 minutat e para të shumicës së orëve. ● Mësimdhënia do të integrojë në mënyrë më të theksuar teorinë dhe praktikën, duke përfshirë analiza të veprave artistike të mjeshtërve të mëdhenj dhe diskutime mbi teknikat e aplikuar gjatë ligjëratave. Ky proces do të mbështesë studentët në lidhjen e koncepteve teorike me zhvillimin praktik të aftësive në studio, duke rritur kështu kuptimin kritik dhe aplikimin krijues të njohurive. ● Studentëve do tu jepen instruksione, këshilla, korrekturë e punës praktike, përkrahje teknike, 		

	<p>kritikë individuale dhe grupore, demonstrime për të kuptuar përdorimin e materialeve të caktuara dhe pajisjeve, dhe detyra për të qartësuar idetë e paraqitura- prezantuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të punohet intensivisht në studio- punë praktike nën mbikqyrjen e mësimeve të mësimit. • Shumica e punëve praktike të realizuara do të përcillen me ese të shkruara të cilat do të hartohen duke u bazuar në ditarin e studentëve (ditari do të përmbajë shënime- skica dhe zhvillimet e projektit në proces, që nga fillimi deri në përfundim). • Detyrat e shtëpisë do të jenë pjesë e pandashme e rrjedhës dhe zhvillimit të programit. • Studentët do të hartojnë seminare në baza semestrare me qëllim të informimit lidhur me rrjedhat e artit dhe qartësimin të ideve e që do të ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik për artin bashkëkohor. 		
Metodat e vlerësimit:	<p>Sistemi i vlerësimit të vazhdueshëm të lëndës: Pikturë I</p> <p>Vlerësimi i lëndës është i strukturuar në katër etapa kryesore (vlerësime), të cilat ndjekin progresin e studentëve gjatë realizimit të projekteve dhe angazhimeve praktike. Secili vlerësim ka peshë të ndryshme në totalin e pikëve (100 pikë), duke pasqyruar progresin nga detyrat bazë deri te ato të avancuara.</p>		
Faza 1: Vlerësimi Fillestar (20%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Projekt Praktik “Natyrë e Qetë“	10%	10 pikë	Pikturimi i një natyre të qetë duke përdorur forma gjeometrike dhe teknika monokrome, me fokus në dritë-hije dhe tonet e ngjyrës.
Detyra dhe Skica	3 %	3 pikë	Skicime të natyrës së qetë dhe dokumentimi i procesit krijues.

Ese Reflektuese	2 %	2 pikë	Një ese që përshkruan procesin dhe analizën e elementeve të përdorura në projekt.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	5%	5 pikë	
Totali për Fazën 1	20%	20 pikë	
Faza 2: Vlerësimi i Semestrit të Parë (25%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Projekt “Peizazh”	10%	10 pikë	Pikturimi i një peizazhi duke u bazuar në observimin në ambient të hapur dhe një tjetër bazuar në imagjinatë.
Seminari – Hulumtim mbi Mjeshtrit e mëdhenj	3%	3 pikë	Prezantimi i një hulumtimi mbi teknikat dhe ndikimin e një mjeshtri të madh të artit.
Projekt Portreti dhe Autoportreti	10%	10 pikë	Realizimi i një portreti dhe autoportreti, me fokus në detajet teknike dhe interpretimin personal.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	2%	2 pikë	
Totali për Fazën 2	25%	25 pikë	
Faza 3: Vlerësimi i Semestrit Pranveror (30%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Projekt “Enterieri”	15%	15 pikë	Realizimi i një enterieri duke përfshirë teksturat dhe strukturat e materialeve si qelqi, druri dhe tekstili.
Skica dhe Studime	10%	10 pikë	Përgatitja e skicave dhe studimeve të detajuara për projektet e enterierit dhe triptikut.
Analizë Kritike	3%	3 pikë	Reflektim mbi progresin individual dhe sugjerime për përmirësim të vazhdueshëm.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	2%	2 pikë	
Totali për Fazën 3	30%	30 pikë	
Faza 4: Vlerësimi Përfundimtar (25%)			
Komponenti	Përqindja	Pikë	Sqarim
Triptiku Final	15%	15 pikë	<ul style="list-style-type: none"> ● Pjesa 1 – Natyrë e Qetë: 5%. ● Pjesa 2 – Peizazh: 5%.

			Pjesa 3 – Enterier: 5%.
Ekspozita e Fundvitit	5%	5 pikë	Organizimi dhe prezantimi i punimeve në një ekspozitë publike.
Analiza Përmbledhëse	3%	3 pikë	Dokumentimi dhe reflektimi mbi të gjitha fazat e projektit dhe progresin personal.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	2%	5 pikë	
Totali për Fazën 4	25%	25 pikë	
Totali i Përgjithshëm	100%	100 pikë	
Shpërndarja e Pikëve për Notat			
Pikët < 50		Nota = 5	
Pikët >= 50 dhe Pikët <60		Nota = 6	
Pikët >= 60 dhe Pikët <70		Nota = 7	
Pikët >= 70 dhe Pikët <80		Nota = 8	
Pikët >= 80 dhe Pikët <90		Nota = 9	
Pikët >= 90		Nota = 10	
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> ● Metodat e pikturimit dhe materialet /METKA KRAIGHER- HOZO ● Historia e artit/ H. Muharremi ● Historia e Artit / E.H. Gombrich ● Historia e artit (The story of Art- vëllimi 1)/ Pierluigi de Vecchi & Elda Cerchiari 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> ● Inkurajohen studentët që të mbledhin dhe shfrytëzojnë informacione mbi teknikat dhe metodat e pikturimit, artin dhe zhvillimet e tij përmes medimeve të ndryshme (internet, medime të shkruara etj). ● Njohuri për ARTIN/ Rosie Dickins dhe Mari Griffith 		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java 1:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjërata: Prezantimi i syllabusit, metodave të vlerësimit, dhe detyrave praktike. Diskutim mbi rëndësinë e natyrës së qetë në pikturë. ● Praktikë: Njohja me materialet dhe medimet. Eksperimentim fillestar me vizatime të thjeshta në bllokun e skicave. 		

Java 2:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Rëndësia e formave gjeometrike si bazë për kompozicionin artistik. ● Praktikë: Pikturimi i një natyre të qetë bazuar në forma gjeometrike (kubi, koni, sfera) duke përdorur teknika monokrome.
Java 3:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Ndikimi i dritës dhe hijes në formësimin e objekteve dhe krijimin e thellësisë vizuale. ● Praktikë: Vazhdimi i punës mbi natyrën e qetë me fokus në dritë-hije.
Java 4:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Ngjyrat primare, sekondare, komplementare dhe ndikimi i gradacionit të toneve të ngjyrës në harmoni. ● Praktikë: Krijimi i një palete ngjyrash dhe eksperimentimi me kontraste të toneve të ngjyrës në një natyrë të qetë.
Java 5:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Teknikat alla prima dhe lazura, krahasimi i avantazheve dhe sfidave të secilës metodë. ● Praktikë: Vazhdimi i projektit “Natyre e Qetë” duke përdorur teknikën alla prima.
Java 6:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutimi mbi rëndësinë e analizës kritike për përmirësimin e procesit krijues. ● Praktikë: Reflektim mbi projektet e natyrës së qetë; korrigjime dhe përmirësime bazuar në kritikë.
Java 7:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Si të shkruhet një ese reflektive që lidh procesin krijues me konceptet teorike. ● Praktikë: Puna mbi ese “Loja e formave gjeometrike në hapësirë” dhe skica mbështetëse.
Java 8:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Historia dhe rëndësia e peizazhit në art. ● Praktikë: Pikturimi i një peizazhi bazuar në observim direkt në ambient të hapur.
Java 9:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Ndikimi i dritës dhe ngjyrave të ndryshme në peizazh. ● Praktikë: Vazhdimi i peizazhit me përqendrim në tonet dhe harmoninë e ngjyrave.
Java 10:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutim mbi progresin individual dhe krahasimi i teknikave të përdorura. ● Praktikë: Reflektim dhe përmirësim i detajeve në peizazh.

Java 11:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Analizë e veprave të mjeshtërve të mëdhenj dhe ndikimi i tyre në artin bashkëkohor. ● Praktikë: Prezantimi i hulumtimeve mbi mjeshtër të zgjedhur dhe interpretimi në bllokun e skicave.
Java 12:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Historia dhe teknikat e realizimit të portretit në artin antik. ● Praktikë: Pikturimi i një portreti sipas modelit antik duke përdorur ngjyrat monokrome.
Java 13:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Teknikat dhe sfidat e punës me modele të gjalla. ● Praktikë: Pikturimi i një portreti të gjallë me ngjyra polikrome.
Java 14:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Reflektimi personal dhe teknikat për krijimin e një autoportreti. ● Praktikë: Fillimi i një autoportreti duke përdorur observimin direkt.
Java 15:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutim mbi rezultatet e portretit dhe autoportretit; sfidat dhe përmirësimet. ● Praktikë: Puna mbi detajet e portretit dhe autoportretit.
Java 16:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Konceptimi i hapësirës dhe përdorimi i formave të enterierit në pikturë. ● Praktikë: Pikturimi i fragmenteve të enterierit me fokus në strukturë.
Java 17:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Trajtimi i materialeve si qelqi, druri dhe tekstili në enterier. ● Praktikë: Integrimi i këtyre elementeve në kompozimin e enterierit.
Java 18:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Përdorimi i teknikës lazurë për thellësinë dhe transparencën në enterier. ● Praktikë: Aplikimi i lazurës për përmirësimin e detajeve të enterierit.
Java 19:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutim mbi arritjet dhe përmirësimet e projektit të enterierit. ● Praktikë: Reflektim dhe përmirësime të detajuara në enterier.

Java 20:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Konceptimi i një triptiku që përfshin natyrën e qetë, peizazhin dhe enterierin. ● Praktikë: Skica dhe organizimi i fazave të projektit.
Java 21:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Prezantimi i konceptit të triptikut, ndërlidhja e natyrës së qetë, peizazhit dhe enterierit në një tërësi vizuale harmonike. ● Praktikë: Skicimi fillestar i ideve për secilën pjesë të triptikut, analizimi i kompozicioneve dhe diskutim mbi qasjen e personalizuar.
Java 22:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Analiza e elementeve bazë të natyrës së qetë dhe përfshirja e tyre në një projekt të integruar. ● Praktikë: Fillimi i realizimit të pjesës së parë të triptikut (natyrës së qetë) duke punuar me harmoni dhe kontrast.
Java 23:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutim mbi rëndësinë e detajeve dhe thellësisë vizuale në natyrën e qetë. ● Praktikë: Vazhdimi i punës mbi natyrën e qetë me fokus në detaje dhe tonalitet, duke aplikuar teknika për krijimin e volumit dhe strukturës.
Java 24:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Ndikimi i dritës, ngjyrës dhe atmosferës në peizazh, dhe lidhja e tyre me tematikën e triptikut. ● Praktikë: Fillimi i realizimit të pjesës së dytë të triptikut duke u bazuar në studimet e mëparshme të peizazhit ose kujtesën.
Java 25:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Analizë e kontrastit dhe thellësisë në peizazh për të krijuar harmoni me pjesët e tjera të triptikut. ● Praktikë: Vazhdimi i punës në peizazhin e triptikut, duke shtuar detaje dhe duke përsosur tonet dhe përbërjen kompozicionale.
Java 26:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Organizimi hapësinor dhe përdorimi i teksturave dhe elementeve të enterierit për të krijuar një koherencë me pjesët e mëparshme të triptikut. ● Praktikë: Skicimi dhe fillimi i pjesës së enterierit duke përdorur ngjyrat dhe format për të ndërtuar një enterier të balancuar.
Java 27:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Diskutim mbi koherencën vizuale të triptikut dhe rëndësia e detajeve në ndërtimin e enterierit.

	<ul style="list-style-type: none"> ● Praktikë: Vazhdimi i punës mbi enterierin me fokus në ngjyrat, teksturat dhe ndërlidhjen vizuale me pjesët e tjera të triptikut.
Java 28:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Udhëzime mbi rëndësinë e rishikimit të detajeve për të siguruar një prezantim të fortë dhe profesional. ● Praktikë: Rishikimi dhe përmirësimi i secilës pjesë të triptikut duke siguruar një harmoni të përgjithshme vizuale.
Java 29:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Strategjitë e kurimit dhe aranzhimit të punimeve në një hapësirë ekspozuese. ● Praktikë: Përgatitja dhe vendosja e punimeve për ekspozitën finale, duke u fokusuar në renditjen dhe ndërlidhjen vizuale.
Java 30:	<ul style="list-style-type: none"> ● Ligjëratë: Reflektim mbi progresin e përgjithshëm dhe arritjet individuale. Diskutim mbi përvojën e ekspozitës dhe rëndësinë e saj në zhvillimin profesional. ● Praktikë: Vlerësimi përfundimtar i punimeve, duke përfshirë një sesion kritik të përmbledhur për të gjitha pjesët e triptikut dhe për projekte të tjera.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe parimet e integritetit akademik, politikat dhe rregullat e mëposhtme janë përcaktuar për të siguruar një mjedis të drejtë, respektues dhe të orientuar drejt rezultateve të suksesshme akademike.

Respektimi i Orarit dhe Pjesëmarrja në Mësim

- Studentët duhet të respektojnë në mënyrë të rreptë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve. Mosprezenca e paarsyetuar mund të ndikojë negativisht në vlerësimin përfundimtar.
- Studenti duhet të njoftojë paraprakisht mësimdhënësin për çdo mungesë të arsyeshme, duke paraqitur dokumentacion përkatës.
- Pjesëmarrja aktive në ligjëratat dhe diskutime është një pjesë integrale e procesit të nxënies.

Pajisjet dhe Përgatitja e Studentëve

- Studentët duhet të jenë të përgatitur për çdo sesion mësimor, duke sjellë të gjitha mjetet e nevojshme për punë (p.sh., bllokun e skicave, mjete për

pikturim, dhe materiale të tjera sipas temave mësimore).

- Mosplotësimi i këtyre kërkesave mund të ndikojë në vlerësimin e tyre në bazë të angazhimit dhe përgjegjësisë.

Sjellja Akademike dhe Etika Profesionale

- Çdo student duhet të tregojë respekt të plotë ndaj mësimdhënësve, kolegëve dhe stafit administrativ. Çdo sjellje e pahijshme, përfshirë fyerjet ose pengesat e qëllimshme gjatë orës mësimore, do të ndëshkohet sipas rregulloreve disiplinore të Universitetit.
- Diskutimet dhe debatet në klasë duhet të jenë konstruktive dhe të bazuara në mirëkuptim dhe respekt reciprok.
- Studentët janë të ndaluar të përvetësojnë punën e tjetrit dhe të paraqesin atë si të tyre. Plagjiatura dhe mashtrimet akademike do të trajtohen sipas masave disiplinore të Statutit.

Ruajtja e Rregullit dhe Qetësisë

- Studentët duhet të sigurojnë që ambienti mësimor të jetë i pastër, i qetë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Çdo ndotje ose dëmtim i pasurisë së universitetit do të sjellë masa ndëshkimore, përfshirë edhe kompensimin për dëmet.
- Telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknologjike duhet të shkyçen gjatë orëve mësimore, përveç rasteve kur janë të autorizuara nga mësimdhënësi për qëllime mësimore.

Integriteti në Vlerësim dhe Prezantim

- Çdo student duhet të prezantojë punimet e tij/saj të përfunduara me përpikëri dhe në kohë, sipas kërkesave të programit.
- Gjatë provimeve dhe prezantimeve, studentët duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna dhe të shmangin çdo formë mashtrimi.

- Çdo formë plagjiature, kopjimi ose ndihme të paautorizuar gjatë provimeve do të ndëshkohet sipas Statutit.

Obligimet e Studentëve ndaj Procesit të Mësimdhënies

- Studentët janë të obliguar të respektojnë autoritetin akademik të mësimdhënësve dhe të ndjekin udhëzimet e tyre për realizimin e projekteve dhe detyrave mësimore.
- Është e detyrueshme që studentët të mbajnë dokumentacion të vazhdueshëm mbi procesin e tyre krijues (ditar pune), i cili do të përdoret për reflektim dhe vlerësim gjatë dhe në fund të semestrit.

Dispozita për Mosrespektim të Rregullave

- Çdo mosrespektim i rregullave të mësipërme do të rezultojë në masa ndëshkimore të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Prishtinës. Këto masa përfshijnë:
 - Paralajmërime verbale ose me shkrim.
 - Ulje të pikëve në vlerësim.
 - Përfshirje nga provimi ose kursi, varësisht nga serioziteti i shkeljes.
 - Vendimet për masat disiplinore do të merren në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të universitetit.

Këto rregulla janë në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe janë krijuar për të siguruar një mjedis të drejtë, të sigurt dhe të frytshëm për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.